

A MUND TA NDRYSHOJË LIBRI HISTORINË E BOTËS?

# A KENI DËGJUAR PËR "QENIN FLAMAN"?

Po t'i pyesni japonezët se çka dinë për Belgjikën, ata me siguri do të përgjigjen: "Oh, po, birra dhe çokolata". Por ju do të vëreni shikimin e tyre disi të habitur që tregon se nuk kanë një imazh të qartë të këtij vendi. Provonë këtë: "A keni dëgjuar për flamanët"? Këtë herë reagoni i tyre do të jetë ndryshe. Sytë e tyre do të ndriçojnë më shumë dhe ata do të pohojnë fuqishëm duke u munduar të flasin për Antwerp, pa e ditur se ky qytet aktualisht gjendet në Belgjikë. Ata mund të flasin për bukurinë e katedrales së këtij qyteti duke e përshkruar detalisht pikturat e famshme të piktorit Peter Paul Rubens. Disa prej tyre madje edhe do të fillonin të qanin. Tash ju do të ndjeheni plotësisht i hutuar po pasur idenë se çka i bënë ata të ndjehen aq emocional. Emri "flaman" (Vlaanderen në holandisht dhe Flandre në gjuhën frënge) i referohet një rajoni në Belgjikën veriore dhe një pjese përbërëse të shtetit federal të Belgjikës. Por kjo fjalë menjëherë i përkujton japonezët për një tregim të veçantë që quhet "qeni flaman". Në Japoni të gjithë, edhe të rinjtë edhe pleqtë e din saktësisht se çka ka ndodhur me Nello dhe Patrasche në katedralen Antwerp në një natë të ftohtë dimri.

## Tregimi i bukur dhe pikëllues

Tregimi origjinal "Qeni flaman" është shkruar nga autori britanik-francez, Ouida, po ashtu i njohur me emrin Marie-Louise de la Ramée (1839-1908). Libri bën fjalë për tregimin e Nellos, një djalë jetim i cili jetoi në një kasolle në periferi të Antwerpenit së bashku me gjyshin e tij të sëmurë dhe qenin që quhej Patrasche. Nello mbi-jetonte duke shitur qumësht në Antwerpen, ndërsa qeni i tij çdo ditë i ndihmonte të barte karcocën me qumësht. Përkundër skamjes, ata ishin shokë të ngushtë dhe ishin të lumtur. Nello ishte një artist i talentuar. Ai dëshironte të bëhej piktorë i famshëm si Rubens, të cilin e admironte shumë, mirëpo, nuk mund të blinte mjetet për të pikturuar. Ëndrra e tij ishte që një ditë mund t'i shihte pikturat e Rubensit në katedrale. Por, këto piktura ishin të mbuluara me perde të rënda, por ai nuk kishte një monedhë të argjende të paguante për të parë pikturat. Lumturia nuk zgjati shumë. Pasi vdekjes së gjyshit të tij, një javë para krishtlindjeve, Nello u akuzua gabimisht për vënie të zjarrit. I larguar nga kasollja në mbrëmjen e krishtlindjeve ai u nis për në katedrale, qeni i tij i shkoi pas. Rastësisht, dera ishte e hapur dhe Nello i pa pikturat e Rubensit më në fund. Të nesërmen në mëngjes djaloshi Nello

dhe qeni i tij besnik u gjetën të ngrirë nga acari, të përqaftuar fuqishëm para pikturave.

## Fati i çuditshëm e përçollti këtë tregim të bukur

Ouida ka qëndruar vetëm disa ditë në Antwerpen, në vitin 1871. Libri i saj është botuar vitin tjetër në Britani të madhe, dhe më vonë kaloi atlantikun për tu shpërndarë në Shtetet e bashkuara. Kur ajo vdiq në vitin 1908 në Itali, gazeta "the New York Times" ka shkruar një in memoriam të gjatë për jetën dhe punën e saj. Ouida përshkruhet si adhuruese e qenve, e cila shpenzoi të shumtën e të parave nga ardhurat e saj në kafshët e saja të dashura. Diplomati japonez Masujiro Honda, i cili vepronte në New York, ishte prekur nga ky artikull gazete. Ai po ashtu ishte adhurues i qenve. Kështu që ai i dërgoi miqve të tij në Japoni librin "Qeni flaman" të shkruar në anglisht. Në letërën e tij ai shkroi "ky tregim është një kryevepër dhe japonezët do ta pëlqejnë". Japonezët e pëlqenin pasi që miqtë e Hondës e përkthyen librin po atë vit. Libri u bë një nga tregimet më të njohura për fëmijët për shumë gjenerata. Kompania transmetuese e animacionit "Nippon" krijoi seri të animuara të bazuara në ngjarjen e vitit 1975. ky fil u transmetua në televizionin nacional dhe fëmijët e shikuan këtë fil në shtëpi çdo të diele mbrëma. Përderisa, në serinë e animuar tregimi po mbaronte, stacioni televiziv pranoi mijëra telefonata dhe letra nga shikuesit e vegjël që luteshin duke thënë: "Ju lutemi, mos e leni Nello të vdesë!" Për këtë shkak u mbajt një takim emergjent, por, pas një debati të gjatë, producentët më në fund vendosën t'i qëndrojnë besnik syzheut origjinal të tregimit. Seritë e animuara përjetuan një sukses gjigand, dhe qysh prej atëherë janë përsëritur shumë herë në televizionin japonez.

## Misioni i Jan Corteel-it

Në vitin 1982, Jan Corteel ishte në vitin e dytë të punës së tij si zyrtar i turizmit në Antwerpen. Ai qartë mund të kujtoj ditën kur një djaloshi i gjatë japonez hyri në zyrën e tij në stacionin qendror. Djaloshi i bëri pyetjen e cila ndryshoi pjesën tjetër të jetës së tij. A keni dëgjuar për "Qenin Flaman?", djaloshi pyeti me një anglisht të çuditshme. Jan ka lindur dhe është edukuar në Antwerpen, por kurrë nuk kishte dëgjuar për këtë. "Dëshiron të thuash: luani flaman?", u përgjigj ai duke ju referuar simbolit që ishte përdorur nga ushtria flamave me 11 qershor 1302, kur e mposhtën ushtrinë franceze gjatë betejës së madhe në "Golden spurs" (guximet e arta) "Jo, jo. Jo Luani, por, Qeni", insi-toi djaloshi japonez.

Jan u desh të pranonte se nuk mund ti ndihmonte atij për këtë gjë.

Më vonë, Jan pyeti kolegët e tij në zyrën e turizmit.

"Ah, po, ata po e kërkojnë një qen për disa arsye, turistët japonezë", u përgjigj njëri nga kolegët me një mospërfillje të theksuar, duke shtuar "Mendoj se është një libër në bibliotekë që bënë fjalë për të." Kështu Jani vrapoi për në bibliotekë dhe në të vërtetë gjeti librin e vjetër të shkruar në anglisht. Nuk kishte version të përkthyer në gjuhën holandeze apo franceze. Në shënimet e një huazuesi, në mbulesën e librit, Jan, vërejtë se ai ishte lexuesi i pestë gjatë shekullit. Ai e lexoi librin disa herë. Ishte tregimi për Antwerpen, Rubensin dhe katedralen. Ai ndihet i turpëruar të mos e ketë ditur këtë tregim" bënte fjalë për ne. Ndjeja se krejt bota po përmbyses mbi mua", kujton ai.

Jan u përkushtua aq shumë në studimin e librit sa që të tjerët menduan se ai ishte çmendur. Ai dëshironte të mblidhte të gjitha informatat e mundshme. Kështu që kur të shihte ndonjë turist japonez në qytet, ai do t'i pyeste "a keni dëgjuar për "Qenin flaman"?"

"Sigurisht që po, pse, ju nuk e dini"? përgjigjeshin të gjithë turistët.

Jan kërkoi nga ata që t'i dërgonin librat dhe revistat nga Japonia dhe shumë shpejt zyra e tij u mbush me librat për Patrasche. Ishte e pazakonshme për të, të vendoste

të mësojë gjuhën japoneze.

## Rezultatet e Janit

Pastaj ai filloi të pyeste vetën se ku kishin jetuar Nello dhe Patrasche. Ouida, nuk e kishte përmendur emrin e fshatit, por kishte cekur se kasollja e tyre ishte "në afërsi të Antwerpen".

"Ishte në skaj të kanalit të madh, pra ekzistonte vetëm një kanal në Antwerpen, i quajtur Scheldt (ose: Schelde, në gjuhën holandeze). Dhe prej kasolles katedralja gjendej "në verilindje". ju deshtë atij një vit e gjysmë të kërkimeve për të ardhur deri të konkludimi.

## Na ishte njëherë fshati Hoboken

Hoboken ishte fshat, por tash është pjesë e zonës industriale. Jan e zbuloi se në Hoboken gjendej një mulli. Në libër, ishte vendi ku shoqja e Nellos, Aloise jetonte me familjen e saj. Sipas të dhënave vendore, mullisi i cili punonte në mulli kishte një vajzë. Ajo ishte e moshës së njëjtë me Aloise, 12 vjeçare, kur Ouida kishte vizituar fshatin përsëri në shekullin 19-të. Duke ju falënderuar përkushtimeve të Janit, statuja e vogël e Nellos dhe Patrasche, tash qëndron përballë qendrës së informimit në Hoboken. Vizitorët mund të kënaqen me duke shëtitur afër modelit të rindërtuar të mullirit me lartësi prej gjashtë metra dhe Kishës që sipas librit djaloshi dhe qeni i tij ishin varrosur së bashku. Shumë turistë japonezë për 20 minuta udhëtojnë nga Antwerpeni në vendin ku kishte ndodhur tre-

gimi i tyre e preferuar Në katedralen e këtij qyteti, turistët tash mund të shohin pikturat e famshme të Rubensit, "The Elevation of the Cross," (Ngritja e kryqit) dhe "The Descent from the Cross" (Rënia e Kryqit), duke paguar ndonjë monedhë shtesë (por ata paguanë hyrjen) Statistikave të fundit dëshmojnë për entuziazmin japonez për këtë qytet. Në përgjithësi 22,000 Japonez kanë vizituar Antwerpen në vitin 2003, duke u radhitur të si turistët e dytë pas amerikanëve në këtë vend. Pas 24 viteve të përkushtimit për këtë tregim, Jan tash respektohet shumë si një ekspert i Nellos dhe Patrasche. Askush më nuk mendon se ai është i çmendur. Ai është martuar para pesë viteve me një japoneze, Yoshimi. Ai ka vizituar Japoninë më shumë se 15 herë, dhe tash madje u ka shpjeguar tregimin turistëve japonez në gjuhën e tyre.

Kur u publikua libri i përkthyer në gjuhën holandeze në vitin 1985, Jan shkroi në të këtë parathënie "ky libër ka qene "një ambasador sekret" për më shumë se 100 vite". "Tregimi u kthye në Antwerpen më në fund. Ka udhëtuar në tërë botën për 100 vite. Japonezët e kthyen përsëri tek ne" thotë Jan duke qeshur.

## Tregimi "i vërtetë" belg

Megjithatë, prezantimi i tregimit në aspektin e Belgjikës ka dëshmuar të jetë jo pune e lehtë. Në tregim Nello kishte lindur në Ardennes dhe Patrasche ishte një qen flaman i pjesës frënge. Wallonia dhe Flanders u bënë miq dhe jetuan në harmoni" është një tregim i përsosur në gjuhën belge" kishte menduar Jani. Ai i solli seritë e animuara japoneze në televizionet lokale vendore për transmetim, por, të gjitha e refuzuan, duke theksuar se veshjet dhe ndërtesat duken shumë holandeze, duke mos paraqitur "Flamanët". Këto dallime mund të jenë dukur vetëm detale të vogla animatorëve japonez, por dukeshin të jenë dallime të mëdha për njerëzit në Antwerpen. Në vitin 1997, producenti japonez i filmit Shochiku dhe animacioni Nippon krijuan një film të animuar që ishte ripunim i serive të suksesshme televizive. Por, këtë herë, stafi i punëtorëve të filmit njehur shkuan të Jani për të marrë këshilla, sepse ata dëshironin të ishin të saktë në çdo detaje, kështu që produktioni i ri të jetë i pranueshëm në Belgjikë. Pas bisedimeve të gjata, Janë më në fund arriti ti bind televizionet nacionale belge për të transmetuar filmin.

Qysh nga viti 2000, shumë shpesh është transmetuar gjatë mbrëmjes së krishtlindjeve. Kështu që ne mund të konkludojmë se tash belgët e din këtë tregim dhe po ashtu edhe ata ndihen të emocionuar thellë nga fundi pikëllues, por edhe një fund zemërngrohës i tregimit?

## Masaki Takakura

"Crossroads", botim i "European Journalism Centre",

<http://www.ejc.nl/crossroads/>

Përktheu: Fazli Rrezja

